



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhezimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit rishpall :

KONKURS

Titulli i punës: Historian-1 pozitë

Institucioni: Muzeu i Kosovës

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore Grada VIII

Paga: Paga Fikse

Numri i referencës: 20/2018

I përgjigjet: Drejtorit të Muzeut të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të kujdeset për koleksionet historike të Muzeut të Kosovës;
2. Të identifikojë, regjistroj, gjendjen aktuale të koleksionit në Shtëpinë e Pavarësisë, duke kompletuar inventarin e tërësishëm të eksponeve dhe aseteve;
3. Të identifikojë dhe të sigurojë informacion dhe qasje në materialet e rëndësishme historike, që prezantojnë historinë e re të Kosovës, me fokus në vitet e 90-ta;

4. Të përcaktojë se cilat materiale historike meritojnë njohje te veçantë, prezantim dhe promovim, duke përfshirë edhe Trashëgiminë e objektit Shtëpia e Pavarësisë;
5. Të hartojë planin dhe prioritetin e aktiviteteve për rifreskim të ekspozitës dhe konsolidim të rrëfimit;
6. Kryen detyra të tjera profesionale sipas nevojave në Muzeun e Kosovës.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplome universitare në Drejtimin e Historisë;
2. Së paku tri (3)vjet përvojë pune profesionale;
3. Shkathhtësi komunikimi dhe prezantimi (me shkrim dhe me gojë);
4. Mundësi angazhimi për ditët e festave dhe fundjave dhe pune nën presion kohe;
5. Aftësi të punës me fëmijë dhe grupe të ndryshme të publikut.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Ligji i Punës, Nr. 03/L-212, Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore.

Kohëzgjatja e emërimit: Kandidati që pranohet, përmes Konkursit publik, merr kontratë gjashtë (6) mujore, me mundësi të vazhdimit, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomën universitare, Drejtimi Histori ;
- Dëshminë për (3)vjet përvojë pune profesionale;
- Dokumenti i identifikimi.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 16.05.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>)